

**PROGRAM ORIENTUES
PËR PËRGATITJEN E PROVIMIT KOMBËTAR
TË MATURËS SHETËRORE**

PËR ARSIMIN E MESËM

NË LËNDËN:

EKONOMI DHE HYRJE NË FILOZOFI

VITI MËSIMOR 2008-2009

TIRANË 2009

Udhëzime për zbatimin e programit

1. Të përgjithshme

Programi orientues për lëndën me zgjedhje Ekonomi dhe Hyrje në filozofi, përfshin koncepte më të rëndësishme të lëndës, si dhe njohuritë dhe shprehjet themelore që synohen në këtë lëndë. Ky program është bazuar në programet ekzistuese të lëndës Ekonomi të zhvilluar në vitin e tretë të shkollës së mesme të përgjithshme të profilizuar ose jo dhe të lëndës Hyrje në filozofi të zhvilluar në vitin e katërt të shkollës së mesme të përgjithshme të profilit shoqëror.

Programi orientues për provimin me zgjedhje të lëndës Ekonomi dhe Hyrje në filozofi, i vlefshëm për provimet me zgjedhje në kuadrin e maturës shtetërore për vitin shkollor 2008-2009, përbën një dokument të vlefshëm për shkollat e mesme të përgjithshme, nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimet e maturës shtetërore.

- Programi përmban dhe siguron informacionin e nevojshëm për mësuesit e lëndës Ekonomi dhe Hyrje në filozofi të shkollave të mesme të përgjithshme që do të përgatisin maturantët për provimin e Ekonomi dhe Hyrje në filozofi si lëndë me zgjedhje në maturën shtetërore.
- Programi orienton nxënësit për materialet kyç mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehjet kryesore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e lëndës Ekonomi dhe Hyrje në filozofi si lëndë me zgjedhje në maturën shtetërore.
- Programi përbën një dokument zyrtar që duhet zbatuar me korrektesë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të lëndës Ekonomi dhe Hyrje në filozofi si lëndë me zgjedhje për maturën shtetërore.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes nga secili prej grupeve të të interesuarve.

Kujdes i veçantë duhet bërë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe të tezës së provimit të lëndës Ekonomi dhe Hyrje në filozofi si lëndë me zgjedhje për maturën shtetërore, të cilët **nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program**. Banka e pyetjeve dhe teza e provimit duhet të përmbajnë njohuri dhe koncepte të trajtuara në tekstet e vendosura për këtë provim (shih më poshtë).

Mësuesit që do përgatitin nxënësit për provimin e lëndës Ekonomi dhe Hyrje në filozofi, duhet t'i aftësojnë nxënësit jo vetëm për çështjet mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehjet e përcaktuara në këtë program, por duhet të trajtojnë dhe çështje që nuk parashikohen në program, por përmbajnë informacion të rëndësishëm dhe ndihmojnë nxënësit për të përvetësuar më mirë materialin e zgjedhur për provim.

Përgatitja e nxënësve për provimin e historisë, duhet bërë në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë që nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, të koncepteve ekonomike e filozofike dhe të shprehjeve të përcaktuara në program.

2. Udhëzim i veçantë

Testi në lëndën **Ekonomi dhe Hyrje në filozofi** do të ndërtohet duke u bazuar në kërkesat dhe objektivat e programit të lëndës së ekonomisë dhe të filozofisë.

Testi synon të vlerësojë atë çfarë di dhe është i aftë të bëjë nxënësi në fund të shkollës së mesme në lëndën e ekonomisë dhe të filozofisë, duke u bazuar në kërkesat e programit dhe në mundësitë që ofrojnë tekstet e vendosura më sipër.

Kjo do të thotë se:

1. Maturanti testohet për të vlerësuar shkallën e përvetësimit prej tij të njohurive, të ideve dhe të koncepteve bazë të lëndës, Programi në vijim përmban pikërisht fushat, temat, çështjet dhe konceptet kryesore të përzgjedhura për t'u testuar në këtë provim
2. Maturanti testohet për aftësitë intelektuale të vëzhgueshme dhe të matshme të synuara nga programi dhe të zhvilluara gjatë zhvillimit të lëndës në shkollë të tilla, si:

1. **Aftësia për të identifikuar dhe përshkruar (nivel i ulët intelektual)**
2. **Aftësia për të shpjeguar dhe analizuar (nivel mesatar intelektual)**
3. **Aftësia për të vlerësuar, marrë dhe mbrojtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë intelektual)**

1. Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar

- ☞ **Të identifikosh** do të thotë të zbulosh kuptimin e gjërave të prekshme (për shembull ministrat ose jo të prekshme (për shembull koncepte të tilla si drejtësia, barazia etj). Të identifikosh diçka do të thotë ta dallosh atë nga diçka tjetër, ta klasifikosh ose ta gruposh sipas ngjashmërisë etj.
- ☞ **Të përshkruash** do të thotë dallosh, me shkrim ose me gojë, karakteristikat kryesore të një sendi ose dukurie. Këto mund të jenë sende të prekshme, konkrete, por mund të jenë edhe procese, institucione, qëllime etj.

2. Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar

- ☞ Të **shpjegosh** do të thotë të identifikosh, të përshkruash, të qartësosh ose të interpretosh diçka, për shembull, shkaqet e ngjarjeve, kuptimin e ngjarjeve ose ideve të caktuara, arsyet për ndërmarrjen e veprimeve ose qëndrimeve të caktuara.
- ☞ Të **analizosh** do të thotë të ndash diçka në pjesët e saj përbërëse për të qartësuar kuptimin ose rëndësinë e saj, për shembull, për të kuptuar shkaqet e ngjarjeve, pjesët përbërëse dhe pasojat e ideve, e proceseve të caktuara shoqërore, politike ose ekonomike.

3. Aftësia për të vlerësuar, marrë dhe mbrojtur qëndrime të caktuara

- ☞ Të vlerësosh do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të gjykuar për shembull për anët e forta ose të dobëta të qëndrimeve që lidhen me çështje të caktuara, synime, mjete etj.
- ☞ Të marrësh një qëndrim të caktuar do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të arritur në një qëndrim që individi e zgjedh nga një numër i caktuar qëndrimesh ose në një qëndrim të ri.
- ☞ Të mbrosh një qëndrim të caktuar do të thotë të përdorësh argumente dhe fakte që mbështetin atë qëndrim ose të kundërshtosh një qëndrim të caktuar duke marrë parasysh edhe argumentet që i kundërvihen qëndrimit tënd.

Model i shpërndarjes së pikëve që rrjedhin nga pyetje të niveleve të ndryshme në test

Nivelet e aftësive intelektuale		
Niveli u ulët	Niveli mesatar	Niveli lartë
Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur një qëndrim të caktuar...
40%	40%	20%

Shembuj rezultatesh komplekse të nxëni që mund të maten/vlerësohen me anë të:

1. testeve që varen nga një kontekst i caktuar në të cilën nxënësi pasi lexon ose analizon një material të caktuar informativ, plotëson një ose më shumë detyra
2. eseve me përgjigje të kufizuara
3. eseve me përgjigje të zgjeruara

1. Rezultate të nxëni që mund të vlerësohen me anë të testeve që varen nga një kontekst i caktuar janë për shembull, aftësitë:

1. Për të dalluar lidhjet shkak-pasojë
2. Për të dalluar zbatimin e parimeve
3. Për të dalluar argumentet që kanë lidhje me çështjen
4. Për të dalluar hipoteza të arsyeshme
5. Për të dalluar përfundime të vlefshme etj.

2. Rezultate të nxëni që mund të vlerësohen me anë të eseve me përgjigje të kufizuara janë, për shembull, aftësitë:

1. Për të shpjeguar lidhjet shkak-pasoja
2. Për të përshkruar zbatimin e parimeve
3. Për të paraqitur argumente të vlefshme
4. Për të formuluar hipoteza të arsyeshme
5. Për të formuluar përfundime të vlefshme

3. Rezultate të nxëni që mund të vlerësohen me anë të eseve me përgjigje të zgjeruara janë për shembull, aftësitë:

- Për të prodhuar, organizuar dhe shprehur ide
- Për të lidhur të nxënit në fusha të ndryshme të dijes
- Për të krijuar modele origjinale
- Për të vlerësuar ide të vlefshme

3. Materiali burimor për përgatitjen e nxënësit për testimin në lëndën me zgjedhje Ekonomi dhe Hyrje në filozofi

Materiali burimor që do të përdoret nga maturantët, mësuesit e tyre dhe autorët e testeve për provimin me zgjedhje në lëndën Ekonomi dhe Hyrje në filozofi kanë këto të dhëna:

1. Teksti me titull: "Ekonomia,

Autorë: Ahmet Mançellari, Sulo Hadëri, Stefan Qirici
Botim 2006

2. Teksti me titull: "Ekonomia", profili natyror.

Autorë: Ahmet Mançellari, Sulo Hadëri, Stefan Qirici.
Botimi i parë: 2001.
Ribotimi: 2003.

☞ **Këto tekste janë të vlefshëm për të gjitha shkolla e mesme të përgjithshme dhe të profilizuara !**

3. Teksti me titull "Hyrje në filozofi" që përdoret në profilin shoqëror.

Autorë: Gjergj Sinani, Fatmira Myteberi
Botimi i parë: 2000, dhe çdo ribotim tjetër i tij.

☞ **Teksti është i vlefshëm për shkollat e mesme të përgjithshme të paprofilizuara dhe për të dy profilet e shkollave të mesme të profilizuara !**

4. Programi tematik

Ekonomia¹

Kreu I Çfarë studion ekonomia?

1. Prodhimi dhe mundësitë e prodhimit
2. Çfarë studion ekonomia

Kreu II Sistemi ekonomik i iniciativës së lirë.

1. Sistemet ekonomike dhe problemi ekonomik kryesor.
2. Shtyllat e sipërmarrjes së lire.

Kreu III Kërkesa, oferta dhe çmimi i tregut

1. Kërkesa dhe lakorja e kërkesës
2. Elasticiteti i kërkesës
3. Oferta dhe lakorja e ofertës
4. Elasticiteti i ofertës
5. Ekuilibri i tregut
6. Kontrolli i çmimeve dhe forcat e tregut

Kreu IV Individu konsumator dhe kursyes

1. Konsumatorë dhe kursyes

Kreu V Fillimi i një biznesi

1. Sipërmarrës të suksesshëm
2. Format e organizimit të një biznesi
3. Korporatat (Shoqëritë anonime)
4. Përgjegjësitë e biznesit ndaj konsumatorëve

Kreu VI Financimi i një biznesi

1. Burimet financiare të biznesit
2. Blerja dhe shitja e aksioneve dhe obligacioneve
3. Kontabiliteti i biznesit

Kreu VII Prodhimi dhe kostoja

1. Prodhimi dhe funksioni i prodhimit
2. Prodhueshmëria dhe faktorët që ndikojnë në prodhueshmëri

¹ Ky program bazohet në temat të radhitura sipas tekstit “Ekonomia” që përdoret në aktualisht në shkollë

3. Kostoja dhe kategoritë e kostos

Kreu VIII Si konkurojnë firmat?

1. Konkurenca e plotë dhe karakteristikat bazë të saj
2. Monopoli dhe karakteristikat e tij
3. Konkurenca monopolistike dhe oligopoli
4. Marketingu

Kreu X Qeveria dhe politika fiskale

1. Ekonomia e tregut dhe roli i qeverisë
2. Qeveria si agjent ekonomik
3. Burimet e të ardhurave të buxhetit

Kreu XI Paraja dhe politika monetare

1. Paraja, funksionet, forma dhe oferta e parasë
2. Bankat tregtare dhe roli i tyre si ndërmjetës financiarë
3. Si e krijojnë bankat paranë. Banka e Shqipërisë dhe funksionet kryesore të saj

Kreu XII Stabiliteti ekonomik

1. Ecuria ekonomike dhe GDP-ja
2. GDP-ja dhe metodat e matjes së saj
3. Papunësia, matja dhe format e saj
4. Inflacioni
5. Ciklet e biznesit

Koncepte kryesore të lëndës Ekonomi

Kujdes!

Konceptet e mëposhtme nuk janë shteruese, por ndihmëse dhe orientuese. Ato ndriçojnë dhe theksojnë disa nga problemet kryesore në të cilat duhet të mbështeten nxënësit, mësuesit dhe autorët e testeve. Kjo do të thotë që përdoruesit e këtij programi **nuk duhet të kufizohen vetëm në këto koncepte, por të mbajnë parasysh në tërësi temat e programit.**

- ☞ Kufiri i mundësisë së prodhimit, burimet natyrore, burime njerëzore, kapital, sipërmarrje, ekonomia
- ☞ Ekonomia tradicionale, ekonomia e tregut, ekonomia e komanduar, pronë private, sistem çmimesh, konkurrenca, aftësia sipërmarrëse
- ☞ Kërkesa, funksioni i kërkesës, e mira normale, e mirë inferiore, lakore e kërkesës, elasticitet i kërkesës, ligji i kërkesës, oferta, funksioni i ofertës, lakore ofertës, funksioni i ofertës, çmimi ekuilibër, çmimi tavan, çmimi dysHEME
- ☞ Dobi, paga, rroga, bono thesari, llogari kursimi, bono të korporatës, buxhet familjar
- ☞ Firmat, firmë individuale, firma me ortak, korporata, aksionere
- ☞ Hua afatshkurtra, hua afatgjata, kredi tregtare, aksion, dividend obligacion, bursa, pasivi i bilancit, aktivi i bilancit, vlera neto, deklarata e të ardhurave dhe shpenzimeve
- ☞ Prodhimi, funksion i prodhimit, faktor i ndryshueshëm, faktori fikse, produkt i përgjithshëm fizik, produkti marzhinal fizik, produkti mesatar fizik, standardi i jetesës, prodhueshmëria, ligji i të ardhurave zbritëse, kosto e përgjithshme, kosto fikse, kosto e ndryshueshme, kosto e përgjithshme mesatare, fikse mesatare fikse, kosto mesatare e ndryshueshme, kosto marzhinale.
- ☞ Struktura tregu, konkurrencë e plote, konkurrim monopolistik, oligopol, monopol, të ardhura të përgjithshme, të ardhura mesatare, të ardhura marginale, ekonomizim i shkallës, shkrirje horizontale, vertikale dhe të përziera
- ☞ Eksternalitet të dëmshme dhe të dobishme, taksa të përgjithshme, taksa progresive, taksa regresive, taksa të drejtpërdrejta, taksa të tërthorta,
- ☞ Paraja, paraja përfaqësuese, para e dekretuar, oferta e parasë, bankat, paniku bankar, produkt i brendshëm bruto, forcë punëtore, papunësi, papunësi friksionale, papunësi strukturore, papunësi ciklike, papunësi stimore, norma natyrore e papunësisë, punëzënia e plote, inflacion, inflacion i moderuar, inflacion galopant, hiperinflacion dhe ciklet e biznesit.

Pjesa e dytë: Filozofia

Kreu I Filozofia në shekuj

1. Hyrje

- Përfytyrimet dhe kuptimi për filozofinë në kohë të ndryshme, burimet e dijes filozofike, veçoritë e dijes filozofike, refleksioni...raporti i saj me shkencat.

2. Filozofia antike greke

- Vendi i njeriut në univers, miti, si forma e parë e shpjegimit të botës, vlerësimi i arsyes.
- Lindja e filozofisë antike greke, sofistët.
- Filozofia e Platonit. Çështjet që shtron ajo.
- Filozofia e Aritotelit. Çështjet që shtron ajo.
- Filozofia si kërkim i lumturisë. Skepticizmi dhe stoicizmi, filozofia si ushtrim shpirtëror, nga filozofia te teologjia.

3. Filozofia në mesjetë

- Vendet ku lulëzoi mendimi filozofik në mesjetë, veprat, idetë dhe autorët, shtresimi i popullsisë, nominalizmi dhe realizmi.
- Filozofia e Thoma Aquinit dhe pas tij, problemet, mendimtarët dhe idetë e tyre.

4. Filozofia gjatë rilindjes

- Humanistët dhe mendimtarët e kohës, roli dhe idetë e tyre, vlerësimi i dinjitetit, virtytit dhe natyrës së njeriut.
- Drejt universit të pafundmë, magjia dhe përvoja, nga tronditjet fetare në çështjet politike.

5. Filozofia në shekullin e XVII

- Zbulimet shkencore dhe pasojat, vlerësimi për metodën, filozofia racionaliste, Dekarti, Spinoza, Paskali, Hobsi, Loku dhe idetë e tyre: njeriu, sovraniteti, liria.

6. Filozofia në shekullin e XVIII

- Një dukuri evropiane, deizmi, politika dhe liria, estetika, njeriu, romantizmi, laicizmi.

7. Filozofia në shekullin e XIX

- Revolucioni francez, interpretimet e tij, romantizmi, zhvillimi i shkencave natyrore dhe shoqërore, pasojat e tyre, vlerësimi i ekonomisë, mendimtarët e kohës dhe idetë e tyre.

8. Shekulli XX

- Tiparet themelore ekonomike, shoqërore e politike të shekullit XX, një gjeneratë e trazuar, mendimet e kohës dhe autorët e tyre.
- Filozofia e shek. XX në kërkim të rrugëve të reja. Pozitivizmi, analiza logjike dhe fenomenologjia.

Kreu i II Njeriu dhe bota

9. Ndërgjegjja

- Pikëpamje dhe ide të ndryshme për ndërgjegjen.
- Ndërgjegjja: e vërtetë apo iluzion.
- Bergsoni për ndërgjegjen.
- Ndërgjegjja dhe vlerat e saj.

10. E pandërgjegjshmja

- Pikëpamjet parafrojdiste për të pandërgjegjshmjen.
- Frojdi për të pandërgjegjshmen.
- Filozofët dhe Frojdi.

11. Hapësira

- Ide dhe autorë të ndryshëm për hapësirën.
- Hapësira, boshllëku dhe Zoti.
- Hapësira si intuitë, zbulimi i hapësirave.

12. Koha

- Autorë dhe mendime të ndryshme për kohën.
- Refuzimi i kohës, koha ciklike.
- Përjetësia.

13. Ekzistenca

- Fillimet e ekzistencializmit.
- Kritika ndaj mendimit abstrakt.
- A është ekzistenca një problem filozofik?
- Shpjegimet për ekzistencën.

14. Tjetri

- Tjetri një prani e detyruar.
- Tjetri tek unë dhe përballë meje.
- Tjetri është gjithmonë me mua.
- Rreziku i anonimatit.
- Konflikti, dhembshuria.

15. Liria

- Shpjegime për lirinë në kohë të ndryshme.
- Arbitri i lirë.
- Zgjedhja dhe vullneti.
- Liria e dyshuar.

16. Vdekja

- I dituri dhe vdekja.
- Kuptimi antropologjik.
- Vdekja është gjithmonë e tjetrit.
- Vdekja e mohuar.
- Vdekja dhe pushteti.

17. Historia

- A është historia shkencë? Tri vërejtjet filozofike për këtë çështje.
- Fakti historik, subjektiviteti, sinteza historike dhe shkakësia.

Kreu III Njohja dhe arsyeja

18. Gjuha

- Gjuha e njerëzve dhe gjuha e kafshëve.
- Analiza karteziane e gjuhës.
- Gjuha njeriu dhe automati.
- Funksionet e gjuhës.
- Gjuha dhe arsyeja.

19. Irracionalja

- Ku shihet irracionalja?
- A mund të mendohet irracionalja.
- E pakuptueshmja apo ajo që nuk është kuptuar ende; Autorë të ndryshëm për këtë problem,.
- E panjohshmja apo ajo që nuk është njohur ende.
- Irracionalja dhe arsyeja.

20. Gjykimi

- Ç' do të thotë të gjykosh.
- Dekarti për një përdorim të mirë të shpirtit.
- Raporti i gjykimit me opinionin.
- Bazat e sigurisë së gjykimit (teoritë, autorët dhe kritikët).

21. Teoria e njohjes. Ideja e së vërtetës.

- Si u formulua teoria e njohjes
- -E vërteta dhe realiteti

- -Kriteret e së vërtetës (qartësia, kopje e realitetit, suksemi, e vërteta formale dhe eksperimentale)

Kreu IV Praktika dhe qëllimet

22. Personi

- Personi si rol.
- Personi si subjektivitet.
- Personi si subjekt etik.

23. Morali

- Problemi moral.
- Natyra e ndërgjegjes morale.
- Detyra.

24. E drejta

- E drejta dhe morali.
- E drejta natyrore dhe e drejta pozitive.
- Thelbi i së drejtës.
 - E drejta dhe forca.
 - E drejta dhe shoqëria (drejtimitet filozofike për këtë çështje).

25. Shteti dhe pushteti

- Kuptimi për shtetin dhe pushtetin në histori. Raporti ndërmjet tyre.
- Pushteti duhet të flasë, pushteti duhet të shikojë, pushteti dhe dija.

Koncepte kryesore të lëndës Hyrje në filozofi

Kujdes!

Konceptet e mëposhtme nuk janë shteruese, por ndihmëse dhe orientuese. Ato ndriçojnë dhe theksojnë disa nga problemet kryesore në të cilat duhet të mbështeten nxënësit, mësuesit dhe autorët e testeve. Kjo do të thotë që përdoruesit e këtij programi **nuk duhet të kufizohen vetëm në këto koncepte, por të mbajnë parasysh në tërësi temat e programit.**

Koncepte kryesore të lëndës

Koncepte nga kreu i parë me titull “Filozofia në shekuj”

Filozofi, refleksion, mit, sofist, e mira dhe e drejta, forma, shpirti, reminishenca, arsyetim demonstrativ, sinteza, skeptik, stoik, ataraksi, revolucion shkencor, metoda, dyshimi, substanca, arsyeja dhe zemra, mëkati fillestar, pozitivizëm logjik, empirizëm, pohime “analitike”, pohime “sintetike”, fenomenologji,

Koncepte nga kreu II, III, IV

- Ndërgjegje, jashtësi, ndërgjegje e errësuar,
- E pandërgjegjshme, esi – uni – mbiuni, psikanaliza, parimi i kënaqësisë, parimi i realitetit,
- Gjuhë njerëzore, “gjuha” e kafshëve, konvencionale, natyrore,
- Arsye, e pakuptueshmja, ankthi, absurdi,
- Hapësira – vendi – boshllëku - lëvizja, hapësira gjeometrike, hapësira prezantuese, hapësira “absolute”, hapësira si intuitë,
- Koha – kujtesa – hovi jetësor, kuadri apriori (hapësira dhe koha), pakthyeshmëria e kohës, koha ciklike, përjetësia,
- Gjikimi, opinioni, teoria intelektualiste, teoria voluntariste,
- Teoria e njohjes, e vërteta dhe realiteti, qartësia, e vërteta formale, e vërteta eksperimentale,
- Tjetri, tjetërsimi, anonimati, konflikti, dhembshuria,
- Arbitër i lirë, liria e dyshuar,
- Fakti historik, sintezë historike
- Personi, autonomia e vullnetit, personaliteti,
- Morali, problemi moral, fakti, ndërgjegje dëshmitare, ndërgjegje gjykatëse, detyra
- E drejta, e drejta natyrore, e drejta pozitive, utilitarizmi.

Pesha që zë secila prej lëndëve në pikët e testit është 50% !

Punë të mbarë dhe Suksese!